



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.14**

**2005**

**23 mars**

### P Ë R M B A J T J A

|  |   | Faqe |
|--|---|------|
| Vendim i Kuvendit<br>nr.176, datë 3.3.2005 | Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për Hetimin e<br>Praktikave të Privatizimeve.....   | 539  |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.177, datë 7.3.2005 | Për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për<br>vendosjen dhe kalimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të<br>forcave ushtarake të huaja, si dhe për dërgimin jashtë vendit të<br>forcave ushtarake shqiptare"..... | 539  |
| Vendim i Kuvendit<br>nr.178, datë 7.3.2005 | Për një ndryshim në vendimin e kuvendit nr.176, datë 3.3.2005<br>"Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për Hetimin e<br>Praktikave të Privatizimeve".....  | 540  |
|  | Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit<br>të Popullit për vitin 2004.....  | 541  |

|  |   |     |
|--|---|-----|
| Vendim i KM<br>nr.134, datë 18.2.2005        | Për ngritjen e Sekretariatit të Komitetit Koordinues të Ministerialit të Mbrojtjes së Europës Juglindore (SEDM-CC) dhe të Komitetit Drejtues Politik-Ushtrak/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (PMSC/MPFSEE) në Shqipëri..... | 542 |
| Udhëzim i MPVD dhe<br>MF nr.1, datë 2.2.2005 | Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.6, datë 4.2.2003 “Për taksën mbi ndërtesat”.....  | 543 |
| Urdhër i MF<br>nr.5, datë 10.3.2005          | Për sekuestrimin e pasurive të shtetasit Nabil Abdul Sayadi, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit.....   | 545 |
| Urdhër i MF<br>nr.6, datë 10.3.2005          | Për sekuestrimin e pasurive të shtetasës Patricia Rosa Vinck, e cila rezulton e shpallur në listën e financuesve të terrorizmit.....  | 547 |
| Urdhër i MF<br>nr.7, datë 10.3.2005          | Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit "Global Relief Foundation" (GRF), i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit.....   | 548 |
| Urdhër i MF<br>nr.8, datë 10.3.2005          | Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”, e njohur dhe si “Revival of Islamic Heritage Society” RIHS, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit.....                                   | 550 |
| Urdhër i MF<br>nr.9, datë 10.3.2005          | Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit "Taibah International", i njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit.....   | 552 |
| Urdhër i MF<br>nr.10, datë 10.3.2005         | Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit “Al Haramania”, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit.....   | 553 |

**VENDIM**  
**Nr. 176, datë 3.3.2005**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR HETIMIN E  
PRAKTIKAVE TË PRIVATIZIMEVE**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për Hetimin e Praktikave të Privatizimeve.
- II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për detyrë hetimin e praktikave të privatizimeve për periudhën nga data 1 janar 2002 deri në datën e ngritjes së Komisionit.
- III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita.
- IV. Kryetari i Komisionit është përfaqësues i opozitës.
- V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej tre muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.
- VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të marrë të gjitha masat administrative të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Servet Pëllumbi**

**VENDIM**  
**Nr. 177, datë 7.3.2005**

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT "PËR  
VENDOSJEN DHE KALIMIN NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË  
FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA, SI DHE PËR DËRGIMIN JASHTË VENDIT TË  
FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE"**

Në mbështetje të nenit 83 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 28 pika 3 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për vendosjen dhe kalimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të forcave ushtarake të huaja, si dhe për dërgimin jashtë vendit të forcave ushtarake shqiptare".

II. Komisioni për Sigurinë Kombëtare (komisioni përgjegjës) të shqyrtojë projektligjin brenda datës 15 mars 2005.

III. Brenda datës 14 mars 2005 të paraqiten amendamentet në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

IV. Shqyrtimi në seancë plenare i projektligjit bëhet ditën e enjte, në datën 17 mars 2005.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Servet Pëllumbi**

**VENDIM**  
**Nr. 178, datë 7.3.2005**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.176, DATË 3.3.2005 “PËR  
NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR HETIMIN E  
PRAKTIKAVE TË PRIVATIZIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr.176, datë 3.3.2005 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për Hetimin e Praktikave të Privatizimeve”, pas pikës IV shtohet pika IV/a me këtë përmbajtje:  
“IV/a. Përbërja e Komisionit është:

- |                     |                   |
|---------------------|-------------------|
| 1. Jemin Gjana      | - Kryetar         |
| 2. Erion Braçe      | - Zëvendëskryetar |
| 3. Flamur Rogu      | - Sekretar        |
| 4. Nazmir Bilani    | - anëtar          |
| 5. Lekë Çukaj       | - anëtar          |
| 6. Taulant Dedja    | - anëtar          |
| 7. Fatmir Xhindi    | - anëtar          |
| 8. Sokol Olldashi   | - anëtar          |
| 9. Gani Hoxha       | - anëtar          |
| 10. Gjovalin Bzheta | - anëtar          |
| 11. Luan Malltezi   | - anëtar”.        |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Servet Pëllumbi**

Tiranë, më 7.3.2005

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2004

Kuvendi i Shqipërisë,

Njih dhe mbështet veprimtarinë e Avokatit të Popullit për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën e veprimtarisë së administratës publike shqiptare, përfshirë organet ekzekutive të gjyqësorit dhe të prokurorisë. Duke verifikuar ankesat dhe kërkesat e shtetasve shqiptarë, me zgjidhjet dhe rekomandimet e tij, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndikuar që të gjitha organet dhe autoritetet publike të punojnë më mirë në favor të qytetarëve për të realizuar një qeverisje më të mirë.

Dhënia e ndihmës ligjore nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillave në rastet e konflikteve midis administratës dhe publikut, zbulimi i defekteve të administratës, denoncimi i sjelljeve të këqija të nëpunësve kundrejt qytetarëve, presioni për ndryshimin e procedurave të rënduara dhe të paqarta të administratës publike, krijimi i kushteve që qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre në marrjen e informacioneve të nevojshme nga administrata publike, nxitja e transparencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e saj, angazhimi në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike kanë qenë drejtimet kryesore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit në zbatim të legjislacionit përkatës.

Kuvendi, pasi u njoh me raportin për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2004, në bazë të nenit 26 të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit" dhe nenit 103 pika 2 të Rregullores së Kuvendit konstaton:

Avokati i Popullit tashmë është një institucion kushtetues i konsoliduar në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë, që vepron i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë. Veprimtaria e këtij institucioni është bërë gjithnjë e më publike. Kjo duket në besimin në rritje të publikut shqiptar te ky institucion, si dhe reagimin gjithmonë e më pozitiv të administratës publike shqiptare ndaj rekomandimeve të tij. Institucionet ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut dhe ato homologe e kanë vlerësuar në vazhdimësi veprimtarinë e këtij institucioni.

Kuvendi kërkon që për vitin 2005 t'u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

1. Bashkëpunimit të vazhdueshëm me Kuvendin, jo vetëm për ta informuar më mirë për situatën e të drejtave të njeriut dhe shkeljet e administratës publike në Shqipëri, por edhe për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore, që do të sillnin një efektivitet më të madh të Zyrës së Avokatit të Popullit.

2. Forcimit të bashkëpunimit me të gjitha segmentet e administratës publike shqiptare për rritjen e standardeve të qeverisjes ose thënë më thjesht, për mirëqeverisje, si dhe forcimit të bashkëpunimit me organizma të shoqërisë civile, si grupe presioni pozitiv mbi administratën. Ky bashkëpunim, si dhe ai me median do të konsolidojnë më tej arritjet e deritanishme, me synim rritjen e efektshmërisë së ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit për ngulitjen e praktikave të mira administrative.

3. Vazhdimin të veprimtarisë ndërgjegjësuere të publikut dhe të administratës për vendin dhe rolin e Avokatit të Popullit. Organizimit të ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, duke zbatuar edhe forma të tjera për t'iu afruar sa më shumë publikut.

4. Publikimit më mirë dhe më shumë të problemeve kryesore të evidentuara nga shkeljet e administratës publike në fushën e të drejtave të njeriut, duke kërkuar edhe masa ndaj personave përgjegjës, sipas ligjit.

5. Hapjes së zyrave rajonale dhe caktimit të përfaqësuesve vendorë të Avokatit të Popullit sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe mirëfunksionimit të nënseksionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbi bazën e një studimi paraprak të detajuar.

6. Angazhimit të mëtejshëm për rritjen cilësore dhe sasiore të nivelit të raportimeve pranë organizmave ndërkombëtarë. Kjo duhet të bëhet si në raportet e paraqitura nga pala shtetërore, ashtu edhe në raportet alternative, të përgatitura në bashkëpunim me shoqërinë civile.

7. Domosdoshmërisë për të ndërmarrë nismën ligjore për të realizuar ndryshimet e nevojshme në ligjin organik "Për Avokatin e Popullit", për të reflektuar përmirësimin dhe plotësimin e kompetencave ligjore të Avokatit të Popullit.

Me këtë rast, Kuvendi tërheq vëmendjen e administratës publike shqiptare, përfshirë gjyqësorin dhe prokurorinë, që të vlerësojnë akoma më shumë kërkesat dhe rekomandimet e avokatit të popullit gjatë veprimtarisë së tyre.

## VENDIM

Nr. 134, datë 18.2.2005

### **PËR NGRITJEN E SEKRETARIATIT TË KOMITETIT KOORDINUES TË MINISTERIALIT TË MBROJTJES SË EUROPËS JUGLINDORE (SEDM-CC) DHE TË KOMITETIT DREJTUES POLITIKO-USHTRAK/FORCËS PAQUERUAJTËSE SHUMËKOMBËSHE TË EUROPËS JUGLINDORE (PMSC/MPFSEE) NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të marrëveshjes dhe të protokollit shtesë "Për krijimin e Forcës Shumëkombëshe të Europës Juglindore", ratifikuar me ligjin nr.8544, datë 4.11.1999, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ngritjen e Sekretariatit të Komitetit Koordinues, *ad-hoc*, të Ministerialit të Mbrojtjes së Europës Juglindore (SEDM/CC) dhe të Komitetit Drejtues Politik-Ushtrak/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (PMSC/MPFSEE) në Shqipëri, në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, për bashkërendimin e veprimtarisë së SEDM/CC dhe të PMSC/MPFSEE dhe për zbatimin e vendimeve politike që do të marrin e të programeve që do të miratojnë. Sekretariati i SEDM/CC dhe i PMSC/MPFSEE të funksionojë për një periudhë dyvjeçare, ku veprimtaria parapërgatitore të fillojë më 1 mars 2005, ndërsa veprimtaria zyrtare më 1 korrik 2005, dhe të përfundojë më 31 korrik 2007.

2. Sekretariati i SEDM/CC dhe i PMSC/MPFSEE të ketë 11 veta dhe të përbëhet nga personel, civil e ushtarak, i Ministrisë së Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

- a) Kryetari të jetë civil;
- b) Këshilltari politik të jetë civil;
- c) 2 specialistë të jenë civilë;
- ç) Shefi i Sekretariatit të jetë ushtarak;
- d) Oficeri i shtabit për operacionet;
- dh) Oficeri i shtabit për logjistikën;
- e) Nëpunësi i protokollit të jetë ushtarak;
- ë) Përgjegjësi i administratës të jetë ushtarak;
- f) Nëpunësi i financës të jetë ushtarak;
- g) Përkthyesi i gjuhës angleze të jetë ushtarak ose civil.

Personeli i Sekretariatit përzgjidhet dhe emërohet nga Ministri i Mbrojtjes. Personelit të punësuar, *ad-hoc*, në këtë Sekretariat t'i ruhet pozicioni i vendit të punës së mëparshme, pas përfundimit të afatit të funksionimit të këtij Sekretariatit.

3. Ministria e Mbrojtjes të sigurojë mjediset dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe për funksionimin e Sekretariatit.

4. Kryetari, shefi i Sekretariatit, oficeri i shtabit për operacionet, oficeri i shtabit për logjistikën, oficeri i shtabit për protokollin dhe një specialist civil të jenë në detyrë të përhershme dhe ta fillojnë detyrën më 1 mars 2005, ndërsa pjesa tjetër e personelit më 1 korrik 2005.

5. Pagat e personelit të Sekretariatit të jenë të njëjta me pozicionet e shërbimit civil në administratën publike, si më poshtë vijon:

- a) Kryetari me atë të drejtorit të drejtorisë;
- b) Punonjësit civilë me atë të specialistit të nivelit të mesëm;
- c) Ushtarakët sipas gradës.

Ushtarakët aktivë, të cilët bien në pagë për shkak të emërimit në funksionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, trajtohen me shtesë “ruajtje page” gjatë kohës së qëndrimit në këtë detyrë.

6. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e vitit 2005, zëri “Mallra e shërbime”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për organizimin e takimeve e të veprimtarive të tjera, brenda dhe jashtë vendit.

8. Fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Fatos Nano

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 2.2.2005**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.6, DATË 4.2.2003**  
**“PËR TAKSËN MBI NDËRTE SAT”**

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 25 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, ndryshuar në ligjin nr.9325, datë 6.12.2004, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Ministri i Financave,

**UDHËZOJNË:**

Në udhëzimin nr.6, datë 4.2.2003 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit dhe Ministrisë së Financave “Për taksën mbi ndërtesat”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kapitullin “Baza e taksës mbi ndërtesat”, në fund të pikës 4, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur mungon dokumentacioni i mësipërm i vërtetimit të pronësisë, të dhënat mbi madhësinë e bazës së taksueshme mund të sigurohen nga personat juridikë, fizikë dhe individët, nëpërmjet vetëdeklarimit. Bashkitë/komunat verifikojnë në terren saktësinë e të dhënave të vetëdeklaruar. Në mungesë të të dhënave nga vetëdeklarimet, për ndërtesat e banimit, përcaktimi i madhësisë së bazës së taksueshme mund të bëhet me metoda të tjera të përafërta deri në sigurimin e të dhënave nga burimet zyrtare të përcaktuara me ligj, mbi bazën e të cilave bëhen dhe korrigjimet përkatëse.”.

2. Në kapitullin “Roli i këshillave të bashkive dhe komunave në taksën mbi ndërtesat”, në pikën 1, fjalia e dytë të riformulohet:

“Në kategorinë minimale “Ndërtesa të reja të tjera”, në zërin “Për tregti dhe shërbime” do të përfshihen” dhe shtohet:

a) Ndërtesat për tregtimin e artikujve të ndryshëm me pakicë e shumicë ku bëjnë pjesë:  
- Ndërtesat për tregtimin e artikujve të ndryshëm me pakicë, si dyqanet e tregtimit me pakicë, njësi të ushqimit social (restorante, fast-fud, bar-bufe, disko, kafe-internet, pub e të tjera të ngjashme me to).

- Ndërtesat për tregtimin e artikujve të ndryshëm me shumicë, si magazina, dyqane etj., ku realizohet shitje dhe rishitje me shumicë.

b) Ndërtesat për veprimtari shërbimesh dhe profesione të lira si, më poshtë:

- Ndërtesat për shërbime, si riparim i artikujve elektro-shtëpiakë, radio-televizorë, frigoriferë, lavatriçe, autoservise, pastrim kimik, si dhe sallone bukurie, agjenci këmbimi valute, agjenci turizmi, motele, salla për lojëra të ndryshme dhe ndërtesa të tjera të ngjashme.

- Ndërtesat për profesione të lira, ku bëjnë pjesë zyrat e avokatëve e të noterëve, ekspertëve kontabël të autorizuar e të tjera të kësaj natyre, klinikat e mjekëve, stomatologëve, farmacistëve e të tjera të kësaj natyre, galeritë e artit të çdo lloj natyre që prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike, ndërtesat jopublike të edukimit etj.”.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në kategorinë minimale “Ndërtesa të tjera”, në zërin “Të tjera” do të përfshihen ndërtesat e prodhimit në të cilat realizohet prodhim, përpunim dhe tregtim i artikujve të prodhuar, si p.sh.: ndërtesa për prodhim tullash, tjegullash, blloqe betoni, furra gëlqere etj., të ngjashme me to, ndërtesat për prodhime me karakter ushqimor, si prodhime buke, ëmbëlsirash, pije freskuese, mishi, vaji, bulmeti e të tjera të ngjashme me to, si dhe çdo lloj ndërtese tjetër prodhimi në sektorë të tjerë që nuk bëjnë pjesë në grupet e mësipërme, si p.sh.: fabrika e prodhimit të detergjentëve, fabrika e prodhimit të çimentos, të metaleve etj.”.

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR DHE I  
DECENTRALIZIMIT

**Ben Blushi**

MINISTRI I FINANCAVE

**Arben Malaj**

## RELACION

### PËR PROJEKTUDHËZIMIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.6, DATË 4.2.2003 “PËR TAKSËN MBI NDËRTESTAT””

Shtesat dhe ndryshimet në udhëzimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit dhe të Ministrisë së Financave, nr.6, datë 4.2.2003 “Për taksën mbi ndërtesat” argumentohen sa vijon:

1. Në bazë të nenit 13 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002, ndryshuar me ligjin nr.9325, datë 6.12.2004, për të lehtësuar procesin e përcaktimit të madhësisë së bazës së taksueshme (madhësinë e sipërfaqes) kur mungojnë të dhënat nga organet shtetërore të përcaktuara me ligj, njësitë e qeverisjes vendore mund t’i sigurojnë këto të dhëna (të cilat duhet të verifikohen dhe të azhurnohen në terren) nëpërmjet vetëdeklarimeve nga personat juridikë, fizikë apo individët. Për ndërtesat e banimit, deri në sigurimin e të dhënave nga organet shtetërore, mund të përdoren dhe metoda të tjera të përafërta, atje ku sistemi i vetëdeklarimeve dhe i verifikimit të të dhënave mund të jetë joefikas, veçanërisht për bashkitë me popullsi të madhe.

2. Përcaktimi i bërë në udhëzimin në fuqi, në kapitullin “Roli i këshillave të bashkive dhe komunave në taksën mbi ndërtesat”, pika 1, fjalia e dytë “Në kategorinë minimale “Ndërtesa të tjera”, në zërin “Për tregti dhe shërbime”, duhet të futen ndërtesat për veprimtari prodhuese me destinacion shitjen e tij”, bien në kundërshtim me ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” aneksi 1, ndryshuar me ligjin nr.9325, datë 6.12.2004. Kështu, në aneksin 1 të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” janë përcaktuar nivelet treguese të taksës mbi ndërtesat, të cilat kategorizohen në dy grupe kryesore, të specifikuara si më poshtë:

I. Ndërtesa banimi:

- ndërtuar para vitit 1993;
- ndërtuar gjatë dhe pas vitit 1993.

II. Ndërtesa të tjera:

- për tregti e shërbime;
- të tjera.

Në përputhje me këtë kategorizim, zëri "Ndërtesa të tjera" (pika II) ndahet në dy grupe, pra ndërtesa "për tregti e shërbime" dhe ndërtesa "të tjera". Në këtë të fundit kuptohet që bëjnë pjesë të gjitha ato ndërtesa që nuk përfshihen në emërtimin "Tregti e shërbime", pra ndërtesat prodhuese, pasi nuk ka specifikime të tjera.

Gjithashtu, për të stimuluar sektorët prodhues, kategoritë minimale të taksës mbi ndërtesat në nëndarjen "Të tjera" janë përcaktuar në ligj me të ulëta.

Në kundërshtim me sa thuhet më sipër, udhëzimi nr.6, datë 4.2.2003, pika 1 "Roli i këshillave të bashkive e komunave në taksën mbi ndërtesat" sqaron se në zërin "Tregti e shërbime" duhen të futen ndërtesat prodhuese me destinacion shitjen e tij, duke barazuar në këtë mënyrë nivelet e kategorive minimale të ndërtesave prodhuese me ato për tregti e shërbime, gjë që nuk është e drejtë. Njëkohësisht, ky udhëzim nuk sqaron se çfarë kupton nëndarja "Të tjera".

Për këtë arsye, propozojmë ndryshimet përkatëse, duke bërë specifikimet për çdo nëndarje në pikën II "Ndërtesa të tjera".

Për shtesat dhe ndryshimet në udhëzimin nr.6, datë 4.2.2003 "Për taksën mbi ndërtesat" janë shprehur disa njësi të qeverisjes vendore në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet shkresave zyrtare të dërguara pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit.

Gjithashtu, Shoqata e Bashkive ka ngritur shqetësimin mbi domosdoshmërinë e përmirësimit të udhëzimit nr.6, datë 4.2.2003 "Për taksën mbi ndërtesat", duke u shprehur dakord me shtesat dhe ndryshimet e propozuara në këtë udhëzim.

MINISTRI I PUSHTETIT VENDOR  
DHE I DECENTRALIZIMIT  
**Ben Blushi**

## URDHËR

**Nr. 5, datë 10.3.2005**

### **PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË SHTETASIT NABIL ABDUL SAYADI, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 "Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit" e vitit 1999, të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim, të nenit 17 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit",

## URDHËROJ:

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të:

1.1 shtetasit Nabil Abdul Sayadi.

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për shtetasin e huaj të lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë bankare të identifikuar deri aktualisht, në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të shtetasit të huaj të lartpërmendur.

4. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, zotërimi i tyre, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim të shtetasit të huaj të lartpërmendur, të pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronar i tyre nga data e shpalljes në listën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë, dhe pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 22 janar 2003 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara.

6. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrirja, të bllokuara ose të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërimet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislati në fuqi.

7. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale të lidhura përpara datës së këtij urdhri, me shtetasin e huaj Nabil Abdul Sayadi, depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

8. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjekteve ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin e lartpërmendur. Nëse vëreni, konstatori një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

9. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjektet duke filluar nga data 22 janar 2003 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me shkrim, brenda datës 20.3.2005 drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe administratori i përkohshëm për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, deri në ngritjen e agjencisë përkatëse, për llogaritë bankare, pasuritë, investimet dhe aktivitetet e tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre.

11. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"; Ministria e Financave, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka Qendrore e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, si dhe administratori i përkohshëm i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.586, datë 28.1.2005, deri në krijimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Arben Malaj**

**URDHËR**  
**Nr. 6, datë 10.3.2005**

**PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË SHTETASES PATRICIA ROSA VINCK, E CILA  
REZULTON E SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit” e vitit 1999, të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim, të nenit 17 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”,

**URDHËROJ:**

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të:

1.1 shtetases Patricia Rosa Vinck.

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për shtetasen e huaj të lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë bankare të identifikuara deri aktualisht, në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të shtetasen të huaj të lartpërmendur.

4. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, zotërimi i tyre, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim të shtetasen të huaj të lartpërmendur, të pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjektet, ndonjëri nga emrat e identifikuar, kanë qenë pronarë të tyre nga data e shpalljes në listën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë, dhe pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 22 janar 2003 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara.

6. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrira, të bllokuara ose të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërimet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislativi në fuqi.

7. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale të lidhura përpara datës së këtij urdhri, me shtetasen e huaj Patricia Rosa Vinck depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

8. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjekteve ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin e lartpërmendur. Nëse vëreni, konstatooni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

9. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjektet duke filluar nga data 22 janar 2003 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me shkrim, brenda datës 20.3.2005 drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe administratori i përkohshëm për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, deri në ngritjen e agjencisë përkatëse, për llogaritë bankare, pasuritë, investimet dhe aktivitetet e tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre.

11. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"; Ministria e Financave, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka Qendrore e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, si dhe administratori i përkohshëm i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.586, datë 28.1.2005 deri në krijimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
Arben Malaj

**URDHËR**  
**Nr. 7, datë 10.3.2005**

**PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "GLOBAL RELIEF FOUNDATION" (GRF) , I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCAVE TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit e vitit 1999, të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim, të nenit 17 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit",

**URDHËROJ:**

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të:

1.1 Fondacionit "Global Relief Foundation" (GRF).

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për fondacionin e lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë bankare të identifikuar deri aktualisht, në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të fondacionit të lartpërmendur të specifikuar dhe renditur më poshtë:

|     |                   |   |   |
|-----|-------------------|---|---|
| 3.1 | 3/ 001/ 000101/ 6 | Në Bankën Ndërkombëtare Tregtare (Malajziane) | Fondacioni "Global Relief Foundation" (GRF) |
|-----|-------------------|---|---|

4. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajshme ose e paluajshme, zotërimi i tyre, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim fondacionit të lartpërmendur, të pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, ndonjëri nga emrat e identifikuar, kanë qenë pronar i tyre nga data e shpalljes në listën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë, dhe pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 22 tetor 2002 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara.

6. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrira, të bllokuara ose të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërimet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi.

7. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale të lidhura përpara datës së këtij urdhri, me fondacionin "Global Relief Foundation" (GRF), depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

8. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjekteve ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin e lartpërmendur. Nëse vëreni, konstatooni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te Drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

9. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjektet duke filluar nga data 22 tetor 2002 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet te Drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me shkrim, brenda datës 20.3.2005 Drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe administratori i përkohshëm për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, deri në ngritjen e agjencisë përkatëse, për llogaritë bankare, pasuritë, investimet dhe aktivitetet e tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre.

11. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"; Ministria e Financave, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithëshme; Banka Qendrore e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, si dhe Administratori i Përkohshëm i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.586, datë. 28.1.2005, deri në krijimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
Arben Malaj

**URDHËR**  
**Nr. 8, datë 10.3.2005**

**PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT “RINGJALLJA E TRASHËGIMISË ISLAME”, E NJOHUR DHE SI “REVIVAL OF ISLAMIC HERITAGE SOCIETY” RIHS, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit” e vitit 1999, të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim, të nenit 17 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”,

**URDHËROJ:**

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të:

1.1. Fondacionit “Ringjallja e Trashëgimisë Islame” (“Revival Of Islamic Heritage Society”-RIHS).

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për fondacionin e lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë bankare të identifikuar deri aktualisht, në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të fondacionit të lartpërmendur të specifikuar dhe renditur më poshtë:

|      |                           |   |   |
|------|---------------------------|---|---|
| 3.1. | 11579                     | Bankën Italo-Shqiptare                        | Fondacioni (“Revival Of Islamic Heritage Society” -RIHS), Shoqata “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”  |
| 3.2  | 401111002800CL<br>PRCFUSD | Bankën Kombëtare Tregtare                     | Fondacioni (“Revival Of Islamic Heritage Society”-RIHS), Shoqata “Ringjallja e Trashëgimisë Islame”   |
| 3.3  | 3/001/000223/1            | Në Bankën Ndërkombëtare Tregtare (Malajziane) | Fondacioni (“Revival Of Islamic Heritage Society” - RIHS), Shoqata “Ringjallja e Trashëgimisë Islame” |
| 3.4. | 201-01-40-01-<br>100494-7 | UBA   | Fondacioni (“Revival Of Islamic Heritage Society”-RIHS), Shoqata “Ringjallja e Trashëgimise Islame”   |

4. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, zotërimi i tyre, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim të fondacionit të lartpërmendur, të pasurive të tjera ekzistuese pavarësisht nga pronësia aktuale, në rast se subjekti, ndonjëri nga emrat e identifikuar kanë qenë pronar i tyre nga data e shpalljes në listën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë dhe pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 11 janar 2002 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara.

6. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrira, të bllokuara ose të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërimet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi.

7. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale të lidhura përpara datës së këtij urdhri me Fondacionin (Shoqata) “Ringjallja e Trashëgimisë Islame” (“Revival Of Islamic Heritage Society” - RIHS), depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

8. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjekteve ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin e lartpërmendur. Nëse vëreni, konstatooni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre, duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

9. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjektet duke filluar nga data 11 janar 2002 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me shkrim, brenda datës 20.3.2005, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe administratori i përkohshëm për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, deri në ngritjen e agjencisë përkatëse, për llogaritë bankare, pasuritë, investimet dhe aktivitetet e tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre.

11. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”; Ministria e Financave, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka Qendrore e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, si dhe administratori i përkohshëm e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.586, datë 28.1.2005, deri në krijimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Arben Malaj**

**URDHËR**  
**Nr. 9, datë 10.3.2005**

**PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "TAIBAH INTERNATIONAL", E  
NJOHUR DHE SI SHOQATA NDËRKOMBËTARE E NDIHMAVE, I CILI REZULTON I  
SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 "Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit" e vitit 1999, të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim, të nenit 17 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit",

**URDHËROJ:**

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të:

1.1 Fondacionit "Taibah International", i njohur dhe si "Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave".

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për fondacionin e lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë bankare të identifikuara deri aktualisht, në emër të, prej, për llogari, ose në përfitim të fondacionit të lartpërmendur të specifikuar dhe renditur më poshtë.

4. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, zotërimi i tyre, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim fondacionit të lartpërmendur, të pasurive të tjera ekzistuese pavarësisht nga pronësia aktuale, në rast se subjekti, ndonjëri nga emrat e identifikuar, kanë qenë pronar i tyre nga data e shpalljes në listën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë dhe pasurive të tjera ekzistuese pavarësisht nga pronësia aktuale, në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 11 maj 2004 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara.

6. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrira, të bllokuara ose të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërimet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislativi në fuqi.

7. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale, të lidhura përpara datës së këtij urdhri, me fondacionin "Taibah International", i njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave, depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

8. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjekteve ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin e lartpërmendur. Nëse vëreni, konstatooni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre, duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

9. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjektet duke filluar nga data 11 maj 2004 e shpalljes në listën e Kombeve të Bashkuara, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet te Drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me shkrim, brenda datës 20.3.2005, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe administratori i përkohshëm për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, deri në ngritjen e agjencisë përkatëse, për llogaritë bankare, pasuritë, investimet dhe aktivitetet e tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre.

11. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258 datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"; Ministria e Financave, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka Qendrore e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, si dhe administratori i përkohshëm i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.586, datë 28.1.2005, deri në krijimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
Arben Malaj

**URDHËR**  
**Nr. 10, datë 10.3.2005**

**PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "AL HARAMANIA",  
I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCVESVE TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 "Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit" e vitit 1999, të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim, të nenit 17 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718 datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit",

**URDHËROJ:**

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të:

1.1. Fondacionit "Al Haramania".

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për fondacionin e lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë bankare të identifikuar deri aktualisht, në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të fondacionit të lartpërmendur të specifikuar dhe renditur më poshtë:

|      |                  |  |                            |
|------|------------------|--|----------------------------|
| 3.1  | 3/001/000456/1   | Bankën Ndërkombëtare Tregtare (Malajziane)     | Fondacioni "Al Haramania". |
| 3.2. | 3/ 001/ 000456/1 | Bankën Ndërkombëtare Tregtare (Malajziane)     | Fondacioni "Al Haramania". |
| 3.3. | 2848/ 208/ 01    | Bankën Kombëtare Tregtare                      | Fondacioni "Al Haramania". |
| 3.4. | 100204           | UBA  | Fondacioni "Al Haramania"  |
| 3.5. | 100147           | UBA  | Fondacioni "Al Haramania"  |
| 3.6. |                  | Banka e Kursimeve (aktualisht Reiffeisen Bank) | Fondacioni "Al Haramania"  |

4. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, zotërimi i tyre, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim të fondacionit të lartpërmendur, të pasurive të tjera ekzistuese pavarësisht nga pronësia aktuale, në rast se subjekti, ndonjëri nga emrat e identifikuar, kanë qenë pronar i tyre nga data e shpalljes në listën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë, dhe pasurive të tjera ekzistuese, pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 6 qershor 2004 e shpalljes në listën e Kombeve të Bashkuara.

6. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrira, të bllokuara ose të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërimet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi.

7. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale të lidhura përpara datës së këtij urdhri, me fondacionin "Al Haramania", depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

8. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjekteve ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin e lartpërmendur. Nëse vëreni, konstatooni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

9. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjektet duke filluar nga data 6 qershor 2004 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo me vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me shkrim, brenda datës 20.3.2005, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe administratori i përkohshëm për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, deri në ngritjen e agjencisë përkatëse, për llogaritë bankare, pasuritë, investimet dhe aktivitetet e tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre.

11. Të ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258 datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit; Ministria e Financave, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka Qendrore e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, si dhe Administratori i Përkohshëm i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.586, datë 28.1.2005, deri në krijimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE  
**Arben Malaj**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
  - Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

|     |                                      |      |
|-----|--------------------------------------|------|
| 1.  | KUSHTETUTA (edhe anglisht)           | 600  |
| 2.  | KODI I PROCEDURËS CIVILE             | 500  |
| 3.  | KODI I PROCEDURËS PENALE             | 600  |
| 4.  | KODI PENAL                           | 400  |
| 5.  | KODI I PUNËS                         | 500  |
| 6.  | KODI I FAMILJES                      | 450  |
| 7.  | KODI CIVIL                           | 1000 |
| 8.  | KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN | 900  |
| 9.  | KODI ZGJEDHOR                        | 355  |
| 10. | KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE    | 500  |
| 11. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR   | 1500 |

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

|    |  |      |
|----|--|------|
| 1. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT       | 800  |
| 2. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK | 1000 |
| 3. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL              | 600  |
| 4. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË        | 1500 |
| 5. | PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE               | 1500 |

**DOLI NGA SHTYPI**

|  |             |
|--|-------------|
| <b>TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004</b> | <b>1500</b> |
| <b>TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004</b>     | <b>2000</b> |

Doli nga shtypi më 23.3.2005

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë